



K.DH.SH.II.nr.707/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Tire Center” Sh.p.k me seli në Obiliq, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.296/22 të datës 21.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Tire Center” Sh.p.k me seli në Obiliq, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.296/22 të datës 21.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nën pikën I. të dispozitivit, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Tire Center” Shpk ,e seli në Obiliq të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B., avokat nga Prishtina, Rr. “Isa Boletini” nr.59 dhe atë lidhur me kamatën ligjore 8% sipas periudhave të specifikuara në plotësim të ekspertizës financiare të datës 24.02.2023. nën pikën II. Anulohet pjesërisht aktvendimi nr.01.3.2.2/4511; 5926; 3316/2019 i datës 28.07.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, dhe atë lidhur me kamatën ligjore prej 8% sipas periudhave të specifikuara në plotësim të ekspertizës financiare të datës 24.02.2023, ashtu që ndryshohet pika III dhe IV e aktvendimit nr. 01.3.2.2/4511; 5926; 3316/2019 i datës 28.07.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë dhe Obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit “Tire Center” Shpk me seli në Obiliq për DUD-at R-6668/16.03.2019, R-6669/16.03.2019, R-7885/27.03.2019, R-8020/28.03.2019, R-8138/28.03.2019, R-9903/11.04.2019, R-9917/11.04.2019 të ZBD Prizren, t’ia paguaj kamatën ligjore prej 8% në shumë prej 3,368.78€ sipas periudhave të specifikuara në plotësim të ekspertizës financiare të datës 24.02.2023 në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën III. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit “Tire Center” Sh.p.k me seli në Obiliq të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B. avokat në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar të detyrohet e paditura që ti kthej paditësit mjetet në vlerë prej 50,759.05€ me kamatë

ligjore prej 8% nga data e pagesës e deri në kthimin e plotë dhe atë lidhur me deklaratat unike doganore R-5767/09.03.2019, R-5769/09.03.2021, R-5913/11.03.2019, R-6073/12.03.2019, R-6129/13.03.2019, R-6131/13.03.2019, R-6348/14.03.2019, R-6256/14.03.2019, R-6392/14.03.2019, R-6375/14.03.2019, R-6839/18.03.2019, R-6677/16.03.2019, R-8322/30.03.2019, R-5892/02.04.2019, R-9176/06.04.2019, R-9999/12.04.2019, R-11728/25.04.2019, R-30066/13.09.2019, R-30069/13.09.2019, R-30625/18.09.2019 të ZBD Prizren në tërësi si të pa bazuar. Nën pikën IV. Mbetet në fuqi aktvendimi me nr.01.3.2.2/4511; 5926; 3316/2019 i datës 28.07.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, në pjesën aprovuese pika I dhe II e dispozitivit të të njëjtit. Ndërsa në pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit “Tire Center” Sh.p.k. me seli në Ferizaj, të anulohet aktgjykimi KF.nr.296/22 i datës 21.03.2023 i Gjykatës Komerciale/Dhoma e Shkallës së Parë/Departamenti Fiskal dhe lënda kthehet në gjykatën e Shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63.2 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr. 01.3.2.2/4511; 5926; 3316/2019 i datës 28.07.2021 në pikën I. të dispozitivit të aktvendimit, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit në procedurë “Tire Center” Shpk me seli në Ferizaj për rishqyrtimin e vendimit/ Deklaratave Unike Doganore R-5767/09.03.2019, R-5769/09.03.2021, R-5913/11.03.2019, R-6073/12.03.2019, R-6129/13.03.2019, R-6131/13.03.2019, R-6348/14.03.2019, R-6256/14.03.2019, R-6392/14.03.2019, R-6375/14.03.2019, R-6839/18.03.2019, R-6677/16.03.2019, R-8322/30.03.2019, R-5892/02.04.2019, R-9176/06.04.2019, R-9999/12.04.2019, R-11728/25.04.2019, R-30066/13.09.2019, R-30069/13.09.2019, R-30625/18.09.2019 të ZBD Prizren në tërësi si të pa bazuar. Nën pikën II. Mbeten në fuqi vendimet Deklaratat Unike Doganore R-5767/09.03.2019, R-5769/09.03.2021, R-5913/11.03.2019, R-6073/12.03.2019, R-6129/13.03.2019, R-6131/13.03.2019, R-6348/14.03.2019, R-6256/14.03.2019, R-6392/14.03.2019, R-6375/14.03.2019, R-6839/18.03.2019, R-6677/16.03.2019, R-8322/30.03.2019, R-5892/02.04.2019, R-9176/06.04.2019, R-9999/12.04.2019, R-11728/25.04.2019, R-30066/13.09.2019, R-30069/13.09.2019, R-30625/18.09.2019 të ZBD Prizren. Nën pikën III. Aprovohet kërkesa e subjektit në procedurë “Tire Center” Shpk me seli në Ferizaj me numër unik identifikues 810196669 për rishqyrtimin e vendimeve R-6668/16.03.2019, R-6669/16.03.2019, R-7885/27.03.2019, R-8020/28.03.2019, R-8138/28.03.2019, R-9903/11.04.2019, R-

9917/11.04.2019 të ZBD Prizren si të bazuara. Dhe nën IV. Lejohet kthimi i mjeteve të paguara më tepër subjektit në procedurë me emër të biznesit "Tire Center" Shpk me seli në Ferizaj me numër unik identifikues 810196669 në xhirollogarinë rrjedhëse numër 13-04-0010027879.25 të evidentuar pranë BPB (Banka për Biznes) për DUD-at nr. R-6668/16.03.2019, R-6669/16.03.2019, R-7885/27.03.2019, R-8020/28.03.2019, R-8138/28.03.2019, R-9903/11.04.2019, R-9917/11.04.2019 të ZBD Prizren.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal për këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor me datë 16.02.2023 në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur dhe vërtetimit të gjendjes faktike, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kamatën ligjore 8%, e anulon pjesërisht aktvendimin e të paditurës sa i përket kamatës ligjore prej 8% ashtu që ndryshohet pika III dhe IV e aktvendimit nr. 01.3.2.2/4511; 5926; 3316/2019 i datës 28.07.2021 i Doganës së Kosovës, është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit sa i përket deklaratave doganore R-5767/09.03.2019, R-5769/09.03.2021, R-5913/11.03.2019, R-6073/12.03.2019, R-6129/13.03.2019, R-6131/13.03.2019, R-6348/14.03.2019, R-6256/14.03.2019, R-6392/14.03.2019, R-6375/14.03.2019, R-6839/18.03.2019, R-6677/16.03.2019, R-8322/30.03.2019, R-5892/02.04.2019, R-9176/06.04.2019, R-9999/12.04.2019, R-11728/25.04.2019, R-30066/13.09.2019, R-30069/13.09.2019, R-30625/18.09.2019 të ZBD Prizren dhe është lënë në fuqi aktvendimi i Doganës së Kosovës në pikën I dhe II të dispozitivit të tij, sipas theksimeve si në arsyetim ndër të tjera se: "Gjykata e ka pranuar sit ë bazuar arsyetimin e vendimit kontestues për arsye se e paditura ka konstatuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është i pa mjaftueshëm pasi që paditësi nuk ka prezantuar prova bindëse dhe konkrete për të përcaktuar se ka bërë pagesën e mallit lëndor të përfshirë në DUD-in kontestues. Dhoma e Shkallës së Parë e pranon si të bazuar pretendimin e paditësit lidhur me kamatën ligjore për mjetet e kthyera sipas pikës III. Dhe IV. të dispozitivit të aktvendimit të kontestuar, kjo për faktin se e paditura vet e ka aprovuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R-6668/16.03.2019, R-6669/16.03.2019, R-7885/27.03.2019, R-8020/28.03.2019, R-8138/28.03.2019, R-9903/11.04.2019, R-9917/11.04.2019 të ZBD Prizren dhe ka lejuar kthimin e mjeteve të paguara më tepër, mirëpo nuk ka vendosur lidhur me kamatën ligjore për të njëjtat deklarata doganore. Andaj meqë e paditura ka aprovuar kërkesën e këtu paditësit dhe ka lejuar kthimin e mjeteve të paguara më tepër sikurse në pikën III dhe IV të dispozitivit të aktvendimit kontestues, për gjykatën paraqet fakt të mjaftueshëm për ta cilësuar këtë si rast të zgjedhjes për çështjen përfundimisht në instancë të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor të apeluesit, këtu paditësit. Gjykata ka vlerësuar se në këtë rast kur Dogana e Kosovës vendos në instancë të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor të apeluesit përfshirë edhe rastin sipas aktvendimit kontestues nr. 01.3.2.2/4511; 5926; 3316/2019 të datës 28.07.2021 dhe duke qenë se e njëjta duhet të rikthejë edhe kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme. Gjykata shumë prej 3,368.78€ e ka marrë nga plotësim ekspertiza financiare e datës 24.02.2023 e ekspertit financiar R.F.. Ndërsa gjykata ka vlerësuar si të pa bazuara pretendimet e paditësit se e paditura e ka refuzuar kërkesën e paditësit se edhe përkundër faktit se subjekti ka prezantuar dokumentet si kontratat, tranferet bankare, në disa prej transfereve nuk është shënuar se për cilën dërgesë është bërë pagesa dhe se disa nuk janë të aprovuara apo ekzekutuara, kjo për faktin se gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në kontest tregtar-administrativ është jo i harmonizuar respektivisht transaksionet bankare ndërkombëtare nuk janë të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe përshkrim

të pagesave të kryera për ti lidhur të njëjtat me faturat e DUD-ave kontestues dhe për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqitur vlerën reale të mallit lëndor. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata sipas propozimit të autorizuar të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.2089/2021 të datës 03.06.2022 ka caktuar ekspertizë financiare në kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar R.F.. Eksperti në ekspertizën e tij të datës 11.11.2022 dhe në plotësimin e saj të datës 02.03.2023 e po ashtu edhe në seancën e shqyrtimit kryesor eksperti ka deklaruar se në tërësi ka vepruar në pajtim me aktvendimin e gjykatës nga data 16.02.2023. Llogaritjen e kamatës e ka bërë në pajtim me ligjin. Ka vizituar paditësin në selinë e tij ku edhe ka verifikuar të gjitha transaksionet ndërkombëtare lidhur me këtë rast dhe se referencat e pagesave janë në numër rendor 6 në faqen 4 të ekspertizës. Nga verifikimi i këtyre transaksioneve ka konstatuar se asnjë pagesë nuk e ka si referencë faturën por si referencë janë pagesat e kryera sipas kontratave. Po ashtu në seancë ka deklaruar se nuk ka transaksion me përshkrim “pagesë sipas faturës” dhe vlerë sipas faturës, por ka transaksion me përshkrim “pagesë sipas kontratës” dhe vlerë që i referohet disa faturave”. Gjykata nga ekspertiza financiare dhe plotësimet e saj nuk ka mundur të harmonizoj faturat e DUD-ve kontestues me transaksione përkatëse ndërkombëtare, pra nuk ka mundur të bëjë lidhjen e këtyre transaksioneve me faturat e DUD-ve kontestues, fakt ky i vërtetuar edhe nga deklaratimet dhe sqarimet e ekspertit si në seancën e datës 21.03.2023. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar gjykatës provën materiale faturat dhe transaksionet bankare ndërkombëtare dhe kontratat e shitjes e njëjta nuk ka arritur të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor prandaj gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pa mjaftueshme. Gjykata ka konstatuar se e paditura në rastin konkret ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacion jo të harmonizuar e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar si dhe çmimin vërtet të paguar siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i kësaj gjykate, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, as me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar- aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi mbështetur edhe në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të atakuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka dëshmuar me dokumentacion adekuat dhe bindës për tu dëshmuar vlera reale e paguar për mallin lëndor, dhe për tu bërë zhdoganimi sipas DUD-ave kontestues me metodën e parë (neni 33 të KDA), andaj me të drejtë nga Dogana e Kosovës i është kontestuar vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim, pasi që paditësi nuk ka mundur të argumentoj me prova konkrete pagesën për blerjen e mallit lëndor, dhe

në këtë drejtim gjykata nuk ka mund të pranoj pretendimet në kërkesëpadinë e paditësit. Kolegji njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë, vlerëson se Dogana e Kosovës, bazuar në faktet e cekura si më lartë me të drejtë ka aplikuar metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 i KDA-së, në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës zhdoganimeve të mëhershme, është bërë përcaktimi i çmimit real të zhdoganimit, e jo ai i deklaruar nga subjekti, sipas dokumenteve përcjellëse të mallit.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se nga dokumentet përcjellëse të mallit si në shkresat e lëndës disa transfere janë realizuar me përshkrim të numrit të kontratës, disa transfere janë realizuar për më shumë kontrata, ndërsa disa të tjera janë realizuar me përshkrim pagesë për mall. Prandaj nuk ka një situatë uniforme siç e ka paraqitur gjykata në konstatim, prandaj konstatimet e gjykatës për mos përputhje janë të përgjithësuara dhe nuk pasqyrojnë në mënyrë të drejtë gjendjen faktike në kuptim të ndërlidhjes së pagesave bankare me kontratat e mallrave, përkatësisht faturat e tyre, Dhoma e Shkallës së dytë vlerëson se gjendja faktike e çështjes gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur është vërtetuar në mënyrë të plotë. Kolegji po ashtu vlerëson se dëshmitë në të cilat thirret në ankesë paditësi, vërtetohet se nga gjykata e shkallës së parë janë shqyrtuar në tërësi, por nuk është arrit të dëshmohet se janë prova të qëndrueshme dhe bindëse materiale, për tu dëshmuar vlera reale e mallit, andaj për shkak të metave të tyre nuk janë pranuar si të vlefshme, sepse nuk është dëshmuar vlera reale e mallit lëndor, sipas DUD-ave kontestues. kolegji vlerëson se paditësi nuk ka ofruar prova konkrete dhe se dokumentacioni përcjellës i mallit nuk është i harmonizuar me dispozitën e nenit 123 Të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009, pra paditësi në këtë rast është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit, me përshkrim të numrit të faturës përcjellëse të mallit lëndor.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.707/23, me datë 08.02.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami